



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-3831

Me datë: 13.01.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nenit 20, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.5/27 Prill, 2018, Prishtinë, Kryetari i Komunës së Suharekës, merrë këtë:

A K T V E N D I M

Mbi caktimin e personit përgjegjës

- I. Arb Përzhaku, Specialist Ligjor në Zyrën e Kryetarit, caktohet person përgjegjës për Komunën e Suharekës sipas nenit 20, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik
- II. Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Suharekës.

Arsyetim

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave ligjore të parapara sipas legjislacionit në fuqi cakton Arb Përzhakun personin kontaktues lidhur me Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve publik në Komunën e Suharekës. Detyrat dhe obligimet e personit kontaktues janë të përcaktuara sipas neni 20 i Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe atë:

Institucioni punëdhënës:

- 4.1. mbledh dhe pranon nga burime të ligjshme informata për interesat private të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informatat e ofruara nga media dhe ankesat e qytetarëve sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe çdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi;
- 4.2. verifikon besueshmërinë e burimeve dhe informatave për të vërtetuar konfliktin e interesit;
- 4.3. vë në dijeni zyrtarin për informatat e siguruarat për të dhe që përbëjnë shkak për konflikt të interesit dhe i jep mundësi të provojë të kundërtën nëse kjo kërkohet nga zyrtari;

4.4. njofton me shkrim raportuesin brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për shqyrtimin e mëtejme të informatës.

5. Punëdhënësi i zyrtarit kryen regjistrimin e interesave private të zyrtarit, ndërmerri masat e duhura për zgjidhjen e konfliktit të interesit dhe raporton tek Agjencia brenda afatit kohor të përcaktuar nga ajo.

6. Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucione i dorëzojnë Agjencisë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe statusin e trajtimit të tyre.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Të njoftohen:

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;

Zyrtari;

Arkiva.





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-5542

Me date: **23.01.2023**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 59 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nr.05/L-031, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë0 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008si dhe Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik/A01, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Besart Gashi-Zyrtar ne Drejtorine e Administrates caktohet **Menaxher I Kontrates "Furnizim me leter -niveli local IIot-II "Me nr.të prokurimit : AQP 22-017-111 & UA/2016 22-11950-111.**

- I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të kontrates dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës.
- II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj kontrate, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratës.
- III. Plani i Menaxhimit të kontratës është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Kontratë origjinale.
- IV. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Dergohet:
-Menaxherit të projektit,
- Arkivi

Bali **MUTARRREMAJ**

Kryetar i Komunës



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-6078

Me datë: 24.01.2023

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **Ardit Shehut**, nga fshati Vraniq, Komuna e Suharekës, i dhurohet lloptop nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Dëshmorët e kombit".
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komuna e Suharekës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, përmes Shkollës Filllore të Ulët "Dëshmorët e Kombit", i dhurojnë lloptop **Ardit Shehut**, nga fshati Vraniq, Komuna e Suharekës. Ky vendim vjen si rrjedhojë e solidaritetit sepse i lartpërmenduri për shkak të problemeve shëndetësore ka nevoj për përkrahje në aspektin e logjistikës në mënyrë që mësimnxënja të jetë më e lehtë për të dhe të mos ndikojë në rezultatet e mësimin. Përkrahja e fëmijëve ose e nxënësve të tillë bëhet bazuar në nevojat dhe potencialet e tyre individuale të tyre.



Kopje:

Drejtorisë për Arsim;

Arkivës.



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-6080

Me datë: 24.01.2023

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 nxjerrë:

V E N D I M

- I. **Anis Aliaj**, i dhurohet lllaptop nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "7 Marsi".
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komuna e Suharekës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, përmes Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "7 Marsi" i dhurojnë lllaptop **Anis Aliajt** nga Suhareka. Ky vendim vjen si rrjedhojë e matjes së koeficientit të intelegjencës ose (IQ-Intellegence Quotient) i cili është një rezultat nga një prej disa testeve të standardizuara të hartuara për të vlerësuar intelegjencën njerëzore. Aftësia e jashtëzakonshme mund të shfaqet në një ose më shumë fusha të tilla si: intelektuale, krijuese, artistike, udhëheqëse, ose në një fushë akademike specifike. Përkrahja e fëmijëve ose e nxënësve të tillë me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta në fusha akademike kreative dhe artistike, bëhet bazuar në nevojat dhe potencialet e tyre individuale të tyre.

Kopje:

Drejtorisë për Arsim;
Arkivës.





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-6645

Me datë: 27.01.2023

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **Remzi Bajselmani**, Drejtor në Drejtorinë për Arsim, caktohet zyrtar kompetent nga Komuna e Suharekës i cili do të shërbejë si person kontakti me Grupin Punues të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- II. Drejtoria për Arsim do të kujdeset për transportin dhe ushqimin e fëmijëve gjatë kësaj dite.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në kuadër të aktiviteteve me rastin e shënimit të 15 - vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka për detyrë dhe përgjegjësi organizimin e ndezjes së 1133 qirinjëve nga 1133 fëmijë prej të gjitha Komunave të Republikës së Kosovës, në përkujtim dhe nderim të 1133 fëmijëve të vrarë nga forcat policore, ushtarake e paramilitare serbe gjatë luftës në Kosovë 1998/1999. Por për realizimin e këtij aktiviteti është i nevojshëm bashkëpunimi i Drejtorisë së Arsimit me shkollat në Komunën e Suharekës për përzgjedhjen e 35 fëmijëve të klasave 4 dhe 5 të ciklit të ulët për t'i dërguar me datë 17 shkurt 2023 në ora 16:00 në Prishtinë.

Kopje:
Drejtorisë për Arsim;
Palës;
Arkivës.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

